



NE AVANSOJME BIZNESIN TUAJ

Përmbajtja

05	Fjala përshëndetëse e Drejtorit Gjeneral
07	Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare
07	Produkti i Brendshëm Bruto (GDP)
08	Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore
09	Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet
09	Inflacioni
09	Tregtia e jashtme
10	Punësimi
11	Sistemi bankar dhe financat
13	Vështrim mbi afarizmin e bankës gjatë vitit 2004
13	Numri i llogarive të klientëve
14	Depozitat
15	Kreditimi
17	Qarkullimi i pagesave
18	Të ardhurat dhe shpenzimet
19	Zgjerimi
20	Këshilli drejtues
21	Drejtuesit
22	Bankat korrespondente
23-45	Raporti i auditorëve të pavarur dhe pasqyrat financiare



Hajrullah Zaiti,
Drejtor gjeneral

Banka Ekonomike në tregun financiar të Kosovës ka krijuar një imazh si bankë stabile, si për aksionerët ashtu edhe për depozitarët e kursimtarët.

Banka Ekonomike, sh.a. Prishtinë, që nga licensimi dhe rifillimi i punës në qeshor të vitit 2001 e deri në fund të vitit 2004 ka hapur 7 degë dhe, 13 nëndegë në tërë Kosovën.

Me zgjerimin e rrjetit të Bankës janë krijuar kushtet për rritjen cilësore të shërbimeve bankare: hapja dhe menaxhimi i llogarive bankare, depozitat dhe kursimi, kreditë për persona juridikë e individual, qarkullimi i pagesave në vend dhe jashtë vendi, si dhe shërbimeve të tjera bankare. Banka gjatë vitit 2004 ka zhvilluar aktivitetin afarist në tregun bankar të Kosovës, të përbërë prej 7 bankave komerciale, në kushte të një konkurrence të forte dhe arriti suksese të lakmueshme:

- Numri i klientëve është rritur nga 19.249 në vitin 2003 në 27.809 në fund të vitit 2004.
- Depozitat janë rritur nga 21.5 milion euro në vitin 2003, në 31.3 milion euro në fund të vitit 2004;
- Që nga licensimi i Bankës e deri në fund të vitit 2004 janë lejuar 4.147 kredi në shumë prej 74,993.684 euro, ndërsa janë në shfrytëzim 1.829 kredi në shumë prej 16,869.461 euro. Në krahasim me vitin e kaluar, kreditë janë rritur për 36%.

Duke kryer shërbime të ndryshme bankare, me cilësi, shpejtësi dhe saktësi të duhur, Banka përfundoi vitin 2004 me realizimin e fitimit në shumë prej 993.989 euro, ose më shumë se në vitin 2003 për 56.4%. Raporti i fitimit neto mbi kapitalin në fund të vitit (ROE) ishte 16.8%.

Banka Ekonomike tashmë ka një personel prej 155 personash të punësuar në tërë rrjetin e saj. Shumica e personelit është e re (136) dhe është trajnuar në Bankën

“Duke aplikuar kamata të larta në depozita me afat dhe kursime ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të tyre, ndërsa me politikën kreditore ka finansuar biznesin privat, të ekonomisë familjare, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe individët.”

Ekonomike, bankat korrespondente, në trajnimet e ndryshme të orjentuara nga BPK-ja. Shoqata e bankave komerciale me institute jashtë vendit. Përkushtimi ndaj shërbimeve dhe vlerave të Bankës Ekonomike është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e trajnimit fillestar. Banka Ekonomike në tregun financiar të Kosovës ka krijuar një imazh si bankë stabile, si për aksionerët ashtu edhe për depozitarët e kursimtarët. Duke aplikuar kamata të larta në depozita me afat dhe kursime ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të tyre, ndërsa me politikën kreditore ka finansuar biznesin privat, të ekonomisë familjare, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe individët. Banka Ekonomike, që nga rilincësimi e në vazhdimësi deri në fund të vitit 2004 ka arritur rezultate të mira financiare dhe zgjeruar rrjetin e Bankës me degë dhe nëndegë duke iu falenderuar bashkëpunimit të ngushtë dhe profesional të Asamblesë së Aksionerëve, Këshillit Drejtues dhe komisioneve të tij me menaxhmentin dhe personelin e Bankës.

Aktiviteti i organeve qeverisëse të Bankës është bazuar në respektimin e standarteve të përcaktuara me Rregulloren mbi Licensimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave, Rregullave të BPK-së dhe dispozitave të statutit të Bankës Ekonomike. Banka Ekonomike për çdo vit e bën auditimin e pasqyrave financiare nga një auditor i jashtëm.

Në fund dëshiroj t'i falenderoj të gjithë ata që kontribuan në afarizmin e suksesshëm të Bankës Ekonomike.

Hajrullah Zaiti
Drejtor i përgjithshëm

Prishtinë, 29 prill 2005

2. Vështrimi i përgjithshëm i ekonomisë kosovare

Pas luftës, në mars-qershor të vitit 1999, Kosova nën administrimin e UNMIK-ut dhe në bashkëqeverisje me institucionet e zgjedhura të Kosovës ka pasur progres në rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit, veçanërisht në zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë dhe krijimit të sistemit të qëndrueshëm bankar me 7 banka komerciale të nivelit të dytë, të licencuara nga Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës. Mirëpo, niveli i zhvillimit ekonomik deri në fund të vitit 2004 ishte dukshëm nën nivelin e vitit 1989 dhe nuk ishte i mjaftueshëm për zbutjen e papunësisë, rritjen e standardit të punëtorëve dhe zgjidhjen e problemit të pensionerëve.

Në zhvillimin e ngadalësuar ekonomiko-social të Kosovës ndikuan më së shumti: trashëgimi i ekonomisë së shkatëruar si rrjedhim i menaxhimit të keq që nga viti 1989 dhe djegieve e plaçkitjeve që iu bënë gjatë luftës, ngadalësimi i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, mosinteresimi i investitorëve të huaj për investime në ekonominë kosovare dhe ndërlidhjes së saj me tregun e jashtëm për shkak të moszgjidhjes së statusit të Kosovës.

Kosova, edhe në vitin 2004 realizoi prodhimin e përgjithshëm për kokë banori ndër më të ulëtën në rajon, ndërsa përqindjen e papunësisë ndër më të lartën (55-60%) me tendencë keqësimi. Mbulesa e importit të mallrave dhe shërbimeve me eksporte në fund të tetorit të vitit 2004 ishte shumë e ulët (3, 6%) për shkak të varësisë së ekonomisë kosovare nga importi, që tregon zhvillimin e ulët global dhe strukturat të ekonomisë.

Buxheti i Kosovës i formuar nga të hyrat vetanake (kryesisht nga dogana dhe taksat), në rrethanat e zhvillimit të ulët ekonomik, për herë të parë pas luftës shënoi deficit në fund të vitit 2004 për 129, 5 mil. euro.

Niveli i ulët i pagave të punëtorëve në sektorin publik (arsimi, shëndetësia, policia, etj) dhe privat, pensionet e ulta dhe mosaktivizimi i disa ndërmarrjeve shoqërore (të privatizuara dhe të pa privatizuara), krahas investimeve të vogla në industri e bujqësi, ndikuan në rënien e vazhdueshme të aftësisë blerëse të popullsisë dhe qarkullimit të mallrave e të shërbimeve.

Rënia e akumulimit në sektorin privat të ekonomisë rezultoi me rënien e standardit të punëtorëve dhe ndikoi në varësinë e tyre prej kredive të bankave komerciale dhe mikroinstitucioneve financiare në Kosovë.

2.1 Produkti i brendshëm bruto (GDP)

Produkti i brendshëm bruto (GDP) për kokë banori shënoi rritje minimale nga viti në vit, përkatësisht nga 870 euro në vitin 2001 u rrit në 964 euro në vitin 2004.

Ndërkaq, rritje më të lartë kishte në vitin 2004, në krahasim me vitin 2001, nga 840 euro në 964 euro, ose për 10, 8%.

Rritja minimale dhe niveli i produktit të brendshëm për kokë banori tregon nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës pas luftës, dhe në krahasim me vendet e rajonit të Ballkanit Kosova është vendi më i pazhvilluar. Produkti i brendshëm bruto për kokë banori në vendet e rajonit të Ballkanit në vitin 2003 shënoi rritje graduale. Bosna ka arritur në 1400 euro, Shqipëria në 1600, IRJM dhe SMZ në 2000 ndërsa Kroacia në kreun e tabelës në 5400 euro.¹⁾

Rritja e ulët e produktit të brendshëm në Kosovë ishte pasojë e disa faktorëve: mungesës së prodhimit vendor, investimeve të huaja dhe ngadalësimit të procesit të privatizimit dhe zgjidhjes së statusit të Kosovës, si dhe rënies drastike të donacioneve të bashkësisë ndërkombëtare.

1) Raporti i Komisionit Evropian për ekonominë e vendeve të Ballkanit

Struktura e produktit të brendshëm bruto tregon se në formimin e tij kanë ndikuar tre faktorë kryesorë: asistencë e huaj, dërgimi i mjeteve dhe importet:

Produkti i brendshëm bruto ²⁾

Përshkrimi/periudha	2001	2002	2003	2004
GDP(në mil. euro)	1. 625	1. 735	1. 797	1. 895
GDP për banorë në euro	870	913	930	964
Rritja në përqindje	100	4, 9	6, 9	10, 8
Pagat (dërgesat) e punëtorëve	217	241	241	244
Ndihma nga jashtë	1. 144	902	732	624
Kont. direkt i ndihmës ndërkombëtare	376	314	254	221
Popullata(në 000)	1. 859	1. 948	1. 991	2030

2. 2 Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore

Agjensia Kosovare e Mirëbesimit(AKM) është themeluar në vitin 2002 me qëllim të administrimit , rikonstruimit të ndërmarrjeve publike dhe privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ka filluar më 15 maj 2003 për privatizimin e gjashtë ndërmarrjeve dhe është bllokuar pas raundit të dytë të privatizimit të 18 ndërmarrjeve të tjera , për të vazhduar në vitin 2004.

Gjatë vitit 2003 procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore përfundoi me privatizimin e 23 ndërmarrjeve në shumën e paguar prej 26. 240. 123 euro.

Ndërsa gjatë vitit 2004 u privatizuan edhe 17 ndërmarrje shoqërore, kështu që deri në fund të vitit 2004 u privatizuan 40 ndërmarrje shoqërore në shumën e paguar prej 42, 4 mil. euro. Nga kjo shumë e paguar e mjeteve, punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara do t'i shpërndahet 20%.

Procesi i privatizimit³⁾

<i>Raundi(Tenderi)</i>	<i>Numri i ndërmarrjeve të privatizuara</i>	<i>Shuma e paguar për privatizim(eur)</i>
-i parë në vitin 2003	5	2.335.875
-i dytë në vitin 2003	18	23.904.247
-i tretë në vitin 2004	17	16.200.000
Gjithsej:	40	42.440.122

Ngadalësimi dhe ndërpreja e përkohshme e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ndikoi në rënien e aktivitetit ekonomik dhe në zvogëlimin e interesimit të investitorëve të vendit dhe të huaj për investime në lëmenjtë e ndryshëm.

2) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin" dhjetor /04, nr. 40

3) Autoriteti bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin", dhjetor/04, nr-40

2.3 Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore në fund të vitit 2004 janë realizuar në shumën 626, 2 milionë euro, përkatësisht më pak për 1,2%, në krahasim me vitin e kaluar.

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore kanë shënuar rritje prej vitit 2000 deri në vitin 2003 dhe në vitin 2004 janë më të larta për 117%, në krahasim me vitin 2000.

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore në vitin 2003 e 2004 janë realizuar tërësisht nga të hyrat vendore: dogana, TVSH, tatimi i paragjykuar, tatimi në fitim dhe taksat tjera. Në strukturën e të ardhurave buxhetore, të ardhurat nga dogana grumbullohen në kufi, për shkak të importit të lartë dhe marrin pjesë me 67,6% në vitin 2003 dhe me 69,5% në vitin 2004.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2004 janë realizuar në shumën 755,8 mil. euro, përkatësisht më tepër për 33,2%, në krahasim me vitin e kaluar.

Rritja më e lartë e shpenzimeve të përgjithshme në krahasim me të ardhurat e përgjithshme buxhetore ka rezultuar me deficitin e buxhetit për vitin 2004 në shumën 129,5 milionë euro.

Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet⁵⁾ në mil EURO

<i>Përshkrimi/periudha</i>	<i>2000</i>	<i>2001</i>	<i>2002</i>	<i>2003</i>	<i>2004</i>
Të ardhurat e përgjithshme buxhetore nga taksat	121, 7	249, 7	444, 4	536, 4	540, 0
-dogana	115, 2	208, 7	364, 5	428, 3	435, 8
-taksat tjera	6, 6	41, 0	79, 9	108, 1	104, 2
Të ardhurat tjera	166, 9	122, 3	91, 3	97, 4	86, 2
Cjithsej:	288, 6	372, 0	535, 7	633, 8	626, 2
Shpenzimet e përgjithshme	234, 9	274, 8	428, 6	567, 3	755, 8
Suficiti/deficiti	53, 7	97, 2	107, 2	66, 6	-129, 5

2.4 Inflacioni

Inflacioni gjatë vitit 2004 shënoi rritje të ulët në krahasim me vendet në rajon, për shkak se kërkesa për konsum dhe shërbime të ndryshme ishte shumë më e vogël se oferta, si rezultat i zhvillimit të ngadalësuar ekonomik dhe rënies së standardit të punëtorëve me rritje të vazhdueshme të papunësisë.

Çmimet me pakicë janë rritur gjatë vitit 2004 për 1,5%⁶⁾, duke shënuar rritje më të ulët, në krahasim me vitin e kaluar.

Rritja e inflacionit ishte më tepër rezultat i inflacionit të importuar, për shkak të importit shumë të lartë të mallrave dhe shërbimeve.

2.5 Tregtia e jashtme

Gjatë dhjetë muajve të vitit 2004 janë shënuar aktivitete më të mëdha në import se në eksport të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme⁷⁾.

Shuma e përgjithshme e importit 828,6 milionë euro në fund të tetorit të vitit 2004 ishte më e ulët se në vitin 2002 për 3,1% dhe në vitin e kaluar për 14,9%.

Ndërsa, shuma e përgjithshme e eksportit prej 30 milione euro ishte më e lartë se në vitin 2002 për 8,7% dhe më e ulët se në vitin e kaluar për 15,7%.

Mbulesa e importit me eksport në fund të tetorit të vitit 2004 ishte vetëm 3,6%.

Partnerët kryesorë tregtarë të importeve në fund të tetorit të vitit 2004 me 75% pjesë-marrje ishin: Unioni Evropian(25,9%), Serbia dhe Mali i Zi (18,6%), Maqedonia(14, 1%), Turqia(7, 8%), Bullgaria(3, 9%), Kroacia(2, 5), Shqipëria(2, 2%), etj. Partnerët kryesorë tregtarë të eksporteve me 88, 6 %pjesëmarrje ishin: Unioni Evropian(41, 3%), Maqedonia(24, 3%), Turqia(8, 7%), Serbia dhe Mali i Zi (6, 3%), Shqipëria (4%), Bosna (4%), etj.

4) e 5) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin", dhjetor/04, nr. 40, f. 49, tabela 28

6) e 7) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly statistics Bulletin", dhjetor/04, nr. 40, f. 50, tabela 29 dhe f. 14, 52, 53.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme në fund të tetorit të vitit 2004 rezultuar me këtë strukturë të eksporteve dhe importeve kryesore:

a) Eksportet kryesore:

o metalet dhe mbeturinat 45,9 %
o plastika, druri, ushqimi, etj 33,1 %

Gjithsej: 79,0 %

b) Importet kryesore:

o ushqimi 23,7 %
o metalet 22,1 %
o petrol 13,8 %
o kemikale, druri, plastika 12,6 %
o makineri 11,1 %

Gjithsej: 83,3 %

Ekonomia e Kosovës është e varur nga importi dhe vazhdon të ketë deficit të lartë tregtar në shumë prej 798,6 milionë euro.

Deficiti tregtar ka shënuar rritje prej vitit 2001 deri në vitin 2003. Ndërkaq, në fund të tetorit të vitit 2004, deficiti tregtar është më i ulët se në vitin 2002 e 2003 për shkak se mungojnë shënimet edhe për dy muajt e fundit:

o në vitin 2000 -616,3 mil. euro
o në vitin 2001 -673,9 mil. euro
o në vitin 2002 -827,2 mil. euro
o në vitin 2003 -937,5 mil. euro
o në vitin 2004 -798,6 mil. euro

Gjatë vitit 2003 ka filluar zbatimi i Marrëveshjes së tregtisë së lirë me Shqipërinë, ndërsa gjatë vitit 2004 kanë filluar bisedimet për nënshkrimin e Marrëveshjes së tregtisë së lirë edhe me Maqedoninë.

2.6 Punësimi

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës ka rezultuar me rritjen e vazhdueshme të papunësisë që nga viti 2000.⁸⁾

Periudha	Numri i të papunëve	Femra%	Edukimi		
			elementar %	sekondar %	universitar %
2000	208.074	43,2	58,1	38,8	3,1
2001	237.958	44,1	60,4	37,0	2,6
2002	257.505	44,5	61,5	36,2	2,2
2003	282.305	45,4	63,0	35,3	1,7
2004	301.982	45,7	63,4	35,1	1,5

Numri i të papunëve është rritur prej 208.074 në vitin 2000, në 301.928 në vitin 2004, përkatësisht për 45,1%, me pjesëmarrje të femrave prej 45,7%. Është pozitive rënia e pjesëmarrjes së numrit të papunëve me edukim univerzitar në numrin e përgjithshëm të

8) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin", dhjetor/04, nr. 40, f. 50, tabela 30.

të papunëve.

Të punësuarit kryesisht janë në tregti dhe në sektorin publik me mesataren e pagave 150-180 euro dhe me pjesëmarrje në popullsinë aktive deri në 45%, që është ndër më të ulëtën në rajon.

2.7. Sistemi bankar dhe financat

Duke u bazuar në Rregulloren për Licencimin, Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Bankave të vitit 1999, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës deri në fund të vitit 2004 ka licencuar 7 banka komerciale të nivelit të dytë me 49 filiala dhe 158 nëndegë në tërë teritorin e Kosovës. Selia e bankave komerciale është në Prishtinë, ndërkaq filialat e tyre janë të hapura në 7 qendrat kryesore të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjiilan e Ferizaj. Në këtë mënyrë është krijuar një sistem i qëndrueshëm bankar.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vazhdon të jetë e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut dhe nuk i ka të gjitha autorizimet e një banke qëndrore.

Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale në Kosovë shënuan rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, që nga viti 2000: ⁹⁾

<i>Përshkrimi</i>	<i>2000</i>	<i>2001</i>	<i>2002</i>	<i>2003</i>	<i>2004</i>
Depozita	93.003	492.255	427.194	514.045	692.269
Kredi	3.148	25.916	86.498	232.773	373.668
Fitimi neto	3.852	6.716	2.716	6.801	10.349

Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2004 arriti në 692.269.000 euro dhe ishte më e lartë se në vitin 2000 për 644,3%. Gjatë periudhës pesëvjeçare të ekzistimit të bankave të reja komerciale në Kosovë, depozitat shënuan rënie vetëm në vitin 2002 për 13,2%, në krahasim me vitin 2001, për shkak të konvertimit të DM në valutën e re EUR në fund të vitit 2001 dhe tërheqjes së një pjese të depozitave gjatë vitit 2002. Mirëpo, gjatë vitit 2003 e 2004 u rrit besimi i klientëve në bankat komerciale si rezultat i likuiditetit të qëndrueshëm bankar dhe depozitat u rritën në fund të vitit 2004 për 62% në krahasim me vitin 2002.

Struktura e depozitave të bankave në fund të vitit 2004, me rritjen e vazhdueshme të pjesëmarrjes së depozitave me afat, tregon krijimin e kushteve për një politikë më aktive kreditore:

- llogaritë rrjedhëse 278,7 mil. euro
- depozitat me afat 413,5 mil. euro

Gjithsej: 692,2 mil. euro

Me miratimin e Rregullores mbi hipotekën dhe pengun u krijuan kushtet juridike për sigurimin e kredive dhe bankat komerciale i rriten kreditë më së shumti në vitin 2003 për 169,1% dhe në vitin 2004 për 332%, në krahasim me vitin 2002, duke i dhënë përkrahje financiare aktiviteteve ekonomike, me qëllim të ngritjes së nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit.

Në fund të vitit 2004, pjesëmarrja e kredive në shumën e depozitave arriti në 54% dhe ka mundësi të rritet deri në 70%, nëse krijohen kushtet për zbatimin e tërësishëm dhe me kohë të Rregulloreve për hipotekën dhe pengun.

9) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin", dhejtor/04, nr. 40, f. 35 e 36

Kreditë në vitin 2004 u shfrytëzuan kryesisht nga sektori privat me këtë strukturë brenda ekonomisë:

• tregti	188.100.000	ose	50,3%
• shërbime,turizëm, etj.	111.873.000	ose	29,9 %
• industri	45.558.000	ose	12,2 %
• bujqësi	7.563.000	ose	2,0%
• të tjera	20.574.000	ose	5,6 %
	373.668.000 euro		100 %

Në strukturën e ekonomisë shfrytëzim më të ulët të kredive pati bujqësia,edhe pse ka resurse për një zhvillim shumë më të lartë.Duhet të ndërmerren masa stimulative për zhvillimin e saj,me anë të politikës fiskale,kredi me afat më të gjatë të shfrytëzimit dhe normë më të ulët të interesit.Ndërkaq,shfrytëzimi i ulët i kredive në industri rezultoi me mosinteresimin e investitorëve të vendit dhe të huaj për shkak të ngadalësimit të procesit të privatizimit dhe moszgjidhjes së statusit të Kosovës.

Për shkak të strukturës afatore të depozitave,kryesisht deri një vit,kreditë u shfrytëzuan më së shumti me afat deri një vit.Pati edhe shfrytëzim të vogël të kredive me afat 24 e 36 muaj.

Fitimi neto shënoi rritje,përveç në vitin 2002,qe ishte më i vogël se në vitet e tjera,për shkak se një bankë realizoi humbje.

Moskrijimi i kushteve për zbatimin në tërësi të Rregullores mbi hipotekën dhe mosefikasiteti i sistemit gjyqësor ndikoi në pasigurinë e bankave për orientimin më të lartë të mjeteve të lira në kreditimin e ekonomisë dhe të popullatës.Mjetet e lira përkohësisht janë plasuar në bankat korrespondente me normë të ulët të interesit.

Kapitali financiar i pashfrytëzuar në fund të vitit 2004¹⁰ ishte:

	në mil.euro
o llogaritë rrjedhëse	372
o depozitat në bankat korespodente	320
o trusti i pensioneve	83
o fondi i AKM-së	42
Gjithsej:	817
o kreditë bankare	- 374
Githsej:	443

Nga shuma e mjeteve të lira,mjetet e Trustit të pensioneve dhe Fondit të AKM-së ishin jashtë sistemit bankar.

10)Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës:"Monthly Statistics Bulletin" dhjetor/04, nr.40.


3. Vështrim mbi afarizmin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2004

Banka Ekonomike në fund të vitit 2004 realizoi një shumë aktivesh prej 37,3 mil.euro dhe me shumën e përgjithshme të bilancit prej 38,4 mil.euro, duke përfshirë zërat jashtëbilancor, 7. Në krahasim me vitin e kaluar, shuma e përgjithshme e aktivës ishte më e lartë për 41,6% dhe shuma e bilancit për 38,6%.

Fitimi i përgjithshëm neto për vitin 2004 ishte 794.212 euro dhe në krahasim me vitin e kaluar ishte më i lartë për 56,4%, përkatësisht për 286.441 euro.

Norma e dividendës, duke vënë fitimin neto në raport me kapitalin aksionar gjatë vitit 2004, në shumë 4.725.031 euro, ishte 16,8%.

Ecuritë e realizuara afariste të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2004 ishin në suazat e atyre të planifikuara, përveç depozitave që shënuan rritje më të lartë për 4,3%, përkatësisht u rriten në 31.278.876 euro.




3.1 Numri i llogarive të klientëve

Numri i llogarive të klientëve të Bankës ka shënuar rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, që nga viti 2001. Në fund të vitit 2004 është rritur në 27.809, me këtë strukturë:

Përshkrimi	2001	%	2002	%	2003	%	2004	%
Personi juridik	167	12,9	1.042	7,6	1.66	8,6	2.466	8,9
Personi individual	1.129	87,1	12.702	92,4	17.589	91,4	25.743	91,1
Gjithsej:	1.296	100	13.744	100	19.249	100	27.809	100

Numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve në fund të vitit 2004 ka shënuar rritje për 4,5% ose për 8.560, në krahasim me vitin e kaluar.



Llogaritë e hapura në Bankën Ekonomike u përkasin personave juridikë dhe individual vendës dhe të huaj. Llogaritë e personave individual marrin pjesë me 91,1% në numrin e përgjithshëm të llogarive në fund të vitit 2004.

Në kuadër të llogarive të personave individualë, shumica e llogarive u përkasin llogarive për pagesën e pagave dhe të pensioneve (21.814 në fund të vitit 2004).

Llogaritë bankare sipas strukturës së filialave të Bankës, më së shumti janë të hapura në filialën: në Pejë (6.3948), në Gjakovë (6.162), në Prishtinë (6.152) dhe në Prizren (3.945).

3.2. Depozitat

Shuma e përgjithshme e depozitave (llogaritë rrjedhëse dhe me afat) shënoi rritje në fund të vitit 2004 për 45,1%, në krahasim me vitin e kaluar.

Depozitat janë rritur prej vitit në vit, që nga fillimi i punës së bankës në vitin 2001, me këtë strukturë:

Përshkrimi	2001		2002		2003		2004	
		%		%		%		%
Depozitat pa afat	6.447	71,2	7.119	54,5	8.783	40,7	9.865	31,5
Depozitat me afat	2.6	28,8	5.934	45,5	12.778	59,3	21.414	68,5
Gjithsej:	9.047	100	13.053	100	21.561	100	31.279	100


Në shumën e përgjithshme të depozitave në fund të vitit 2004, prej 31.279 mijë euro, depozitat me afat kanë shtuar pjesëmarrjen në 68,5% që paraqet tendencën e kthimit të besimit të kursimtarëve në Bankë dhe krijimit të kushteve për një politikë stabile kreditore.

Rritja e depozitave ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në shumën e përgjithshme të depozitave në nivel të bankave komerciale në Kosovë, nga 3,1%, në vitin 2002, në 4,1%, në vitin 2003 dhe në 4,5%, në vitin 2004.

Me Planin e biznesit të Bankës Ekonomike për periudhën 2004-2006 është parashikuar rritja e pjesëmarrjes në depozitat e bankave në 5,9% në vitin 2005 dhe në 10,2% në vitin 2006.

Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2004 ka pasur këtë përbërje:

Përbërja e shumës së përgjithshme të depozitave në mil. Euro në fund të vitit 2004




3.3. Kreditimi

Shuma e përgjithshme e kredive është rritur prej 12.403 mijë euro në vitin 2003, në 16.869 mijë euro në fund të vitit 2004, përkatësisht për 36%.


Që nga licencimi i Bankës në qershor të vitit 2001 e deri në fund të vitit 2004 janë lejuar 4.147 krdei në shumë 74.993.684 euro, ndërsa janë në shfrytëzim 1.829 kredi në shumë 16.869.461 euro, me këtë strukturë:

						në 000 EUR					
Të lejuara						Në shfrytëzim					
Ndërmarrjeve		Konsumuese		Gjithsej		Ndërmarrjeve		Konsumuese		Gjithsej	
Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma
1.888	71.530	2.259	3.464	4.147	74.994	447	15.115	1.382	1.754	1.829	16.869


Kreditë më së shumti janë shfrytëzuar nga ndërmarrjet e lëmenjve të ndryshëm.




a) Kreditë sipas destinimit më së shumti janë shfrytëzuar për mjete të gjiros në shumë 14,1 milionë euro ose 83,8% nga shuma e përgjithshme.




b) Kreditë sipas lëmenjve më së shumti janë shfrytëzuar për tregti në shumë 11,4 milionë euro ose 67,4% nga shuma e përgjithshme e kredive. Ndërkaq, më së pakti janë shfrytëzuar për bujqësi 0,47% për shkak të mosstimulimit të bujqësisë me masa të politikës fiskale dhe të tjera.



c) Kreditë sipas afatit më së shumti janë shfrytëzuar më afat prej 6-12 muaj në shumë 4,9 milionë euro ose 29% dhe prej 18-24 muaj me shumë 5,5 milionë euro ose 32,4% nga shuma e përgjithshme.

Kreditë sipas afatit

d) Kreditë sipas filialave të Bankës më së shumti janë shfrytëzuar në Prishtinë më rrethinë 33,1%, Gjakovë 24,5% dhe Pejë 24,3%:

Kreditë sipas filialave

Procesi i kreditimit nga Banka ishte i kujdesshëm ,duke pasur parasysh nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe rënien e aftësisë kreditore të huamarrësve.Përkundër kësaj,gjatë vitit 2003 e 2004 u vështirësua afarizmi i disa huamarrësve,të cilët filluan të mos i paguajnë kreditë dhe Banka u detyrua të bëjë padi gjyqësore në bazë të hipotekës në pasurinë e patundshme,e më pak në bazë të pengut.Janë paditur 52 huamarrës në shumë 583348 euro.Procesi gjyqësor është i ngadalësuar,por shpresohet në suksesin e tij.

Disa huamarrës të paditur kanë filluar pagesën e borxhit.

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në shumën e përgjithshme të kredive të bankave komerciale në Kosovë arrin në fund të vitit 2004 në 4,7%.

Me Planin e biznesit për periudhën 2004-2006 është planifikuar rritja e pjesëmarrjes në 6,5% në vitin 2005 dhe 10,2% në vitin 2006.

3.4.Qarkullimi i pagesave

Qarkullimi i pagesave gjatë vitit 2004 është kryer përmes të bankave korrespondente(transferta e mjeteve jashtë vendit) dhe Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (kliringu).

Shuma e qarkullimit të pagesave të brendshme midis bankave komerciale përmes BPK-së është në rritje prej vitit në vit dhe në fund të vitit 2004 arrin në 129,9 milionë euro ose për 34% më shumë se në vitin e kaluar.

Nga kjo shumë, 61,9 milionë euro janë realizuar përmes transfertes hyrëse të mjeteve për 15-757 transaksione. Ndërsa pjesa tjetër e shumës prej 68,1 milionë euro është realizuar përmes transfertes dalëse të mjeteve për 11.790 transaksione.

Banka Ekonomike në fund të vitit 2004 ka marrë pjesë në shumën e përgjithshme të transaksioneve bankare përmes BPK-së me 7,6%, ndërsa në numrin e përgjithshëm të transaksioneve me 10,3%.

Qarkullimi i pagesave me botën (transferta e mjeteve nga jashtë dhe jashtë vendit) në vitin 2004 është realizuar në shumë 116 milionë euro ose për 26% më shumë se në vitin e kaluar, nëpërmjet tri bankave korrespondente:

- LHB Internationale Handelsbank, Frankfurt,
- BASH Banka Amerikane e Shqipërisë, Tiranë,
- RZB Raiffeisen Zentralbank Oesterich AG, Vjenë.

Transferta e mjeteve jashtë vendit bëhet në mënyrë të shpejtë me anë të bartjes elektronike (LHB-sistemi multikesh, RZB-me internet, BASH-bartje automatike me sistemin ON-LINE). Në kuadër të shteteve evropiane është bërë brenda 24 orëve, kurse për shtetet jashtë Evropës brenda 48 orëve. Ndërsa, transferata e mjeteve nëpërmjet të BASH bëhet menjëherë brenda disa minutave.

Pjesëmarrja e Bankës në shumën e përgjithshme të transfertes hyrëse të mjeteve në nivel të bankave komerciale në Kosovë, në fund të vitit 2004, arrin në 3,9%, ndërsa e transfertes dalëse të mjeteve arrin në 5,6%.

Me Planin e biznesit për periudhën 2004-2006 është parashikuar rritja e vazhdueshme e pjesëmarrjes së Bankës në bilancin e pagesave të Kosovës:

	2005	2006
Eksportet	7%	10%
Importet	12%	14%

Banka ka të instaluar sistemin ON-LINE me të gjitha degët që mundëson kryerjen e menjëhershme të shërbimeve të klientëve, pavarësisht se në cilën degë të Bankës e kanë të hapur llogarinë bankare.

Qarkullimi i pagesave në llogarinë e klientit dhe midis klientëve në tërë rrjetin e degëve të Bankës bëhet gratis.

Banka i stimulon klientët për shërbimet e transfertes së mjeteve në valuta të tjera jashtë vendit pa komision për konvertim të euros në valuta të tjera.

3.5 Të ardhurat dhe shpenzimet

Banka Ekonomike ka realizuar të ardhurat e përgjithshme në shumë 3,6 milione euro ose për 42,3% më shumë se në vitin e kaluar.

Në strukturën e të ardhurave të përgjithshme, pjesëmarrje më të lartë kanë:

- të ardhurat nga interesat në kreditë e dhëna 59,5 %
- komisioni për kreditë e dhëna 9,4 %
- komisioni nga transfertat e mjeteve 9,8 %
- të tjerat 21,35%

Të ardhurat nga interesat në kreditë e dhëna së bashku me të ardhurat nga institucionet financiare vendëse dhe të huaja arrijnë shumën 2.286 mijë euro dhe në krahasim me vitin e kaluar janë rritur për 53%. Nëse këto të ardhura i zvogëlojmë për shpenzimet e interesit në

depozita me afat (456 mijë euro), të ardhurat neto nga interesat janë realizuar në shumën 1.830 mijë euro dhe në krahasim me vitin e kaluar shënojnë rritje prej 54%.

Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në shumë 2,8 milionë euro në fund të vitit 2004 dhe janë rritur për 33,3%, në krahasim me vitin e kaluar, por më pak se të ardhurat për 9%.

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme, pjesëmarrje më të lartë kanë:

• të ardhurat personale	29,3 %
• interesi në depozita me afat	16,2 %
• rezervimet par kreditë e lejuara	16,0 %
• qiratë	7,0 %
• amortizimi i mjeteve themelore	6,7 %
• të tjera	24,8 %

Rritja më e ngadalshme e shpenzimeve të përgjithshme, në krahasim me rritjen e të ardhurave, rezultoi me realizimin e fitimit neto në shumë 794.212 euro, që është më i lartë për 56,4%, në krahasim me vitin e kaluar. Banka pagoi tatimin në fitim në shumë 199.717 eur, përkatësisht 20% në fitimin bruto për vitin 2004.

<i>Treguesit kryesorë</i>	
Raporti i fitimit neto mbi aktivet (ROA)	2,1 %
Raporti i fitimit neto mbi aktivet me risk (RORA)	3,4 %
Raporti i fitimit neto mbi kapitalin në fund të vitit (ROE)	16,8 %
Raporti i kapitalit (klasat) mbi aktivet	12,7 %
Shpenzimet e përgjithshme në raport me të ardhurat e përgjithshme.	78,1 %

3.6 Zgjerimi

Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në tregun bankar, Banka Ekonomike që nga licencimi dhe rifillimi i punës në qershor të vitit 2001 e deri në fund të vitit 2004 ka hapur 7 degë, 1 nëndegë dhe 12 zyre në tërë Kosovën.

Hapja e degëve është bërë në këto periudha kohore:

- Banka me degët në Prishtinë, Gjakovë e Pejë gjatë vitit 2001
- Dega në Prizren dhe Ferizaj gjatë vitit 2002
- Dega në Mitrovicë e Gjilan gjatë vitit 2003.

Ekspozitura është hapur në Burim (Istog) në qershor të vitit 2002, ndërsa zyrat janë hapur kryesisht në pikat doganore dhe të regjistrimit të automjeteve.

Me zgjerimin e rrjetit të Bankës janë krijuar kushtet për rritjen e shërbimeve bankare: depozitat, kreditë për persona juridik e individual, qarkullimi i pagesave të ndryeshme dhe shërbimet e tjera bankare.

Rritja e Bankës ka imponuar planifikimin e ndërtimit të ndërtesës në vitin 2006 dhe kalimin në lokalet më të mira dhe më të mëdha me qira në qendër të Prishtinës gjatë muajit qershor të vitit 2005.

Këshilli drejtues

Bardhyl Minxhozi	Kryetar
Ali Buza	Zëv.kryetar
Hasan Hajdari	Anëtar
Raif Rexhepi	Anëtar
Xhabir Kajtazi	Anëtar
Qerim Ramadani	Anëtar
Gazmend Tuzi	Anëtar
Ismet Gjoshi	Anëtar
Hajrullah Zaiti-	Anëtar
Drejtor i përgjithshëm i Bankës	



DREJTUESIT


Hajrullah Zaiti	Drejtor i përgjithshëm
Mazllom Beqa	Zëvendës drejtor i përgjithshëm
Arbnor Pajaziti	Ndihmës drejtor i përgjithshëm për IT
Syzane Kaçaniku	Ndihmës drejtores e përgjithshme dhe Drejtores e Drejtorisë financiare
Ismet Gashi	Drejtore i Drejtorisë së kreditimit
Xhelal Kusari	Drejtore i Drejtorisë për punë juridike dhe të përgjithshme
Enver Vula	Revizor i brendshëm
Teki Ukmata	Drejtore, Dega Prishtinë
Nuriye Haxhikadrija	Drejtore, Dega Gjakovë
Izet Mahmuti	Drejtore, Dega Pejë
Hysein Kendos	Drejtore, Dega Prizren
Eset Shaqiri	Drejtore, Dega Mitrovicë
Nazmi Dushi	Drejtore, Dega Ferizaj
Selami Shala	Drejtore, Dega Gjiilan

BANKAT KORRESPONENTE

LHB Internationale Handelsbank, Frankfurt, Gjermani

ABA American Bank of Albania, Tiranë, Shqipëri

RZB Raiffeisen Zentral Bank Oesterreich, Vjenë, Austri



BANKA EKONOMIKE, PRISHTINË

PASQYRAT FINANCIARE
DHE
RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

PËR FUNDVITET 31 DHJETOR, 2004 DHE 2003

Përmbajtja

25	Raporti i auditorëve të pavarur
26	Bilanci
27	Pasqyrat e operimeve
28	Pasqyrat e ndryshimeve në ekuitetin e aksionarëve
29	Pasqyrat e rrjedhjes së parasë
30	Aktivitetet kryesore
30	Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël
34	Paraja në dorë dhe në banka
34	Bilancet me autoritetin bankar dhe të pagesave të Kosovës
35	Kreditë ndaj klientëve
37	Prona, planti dhe paisjet
37	Asetet e patrupëzuara
38	Detyrimet ndaj klientëve
39	Llogaritë e pagueshme
39	Fitimet e mbajtura
39	Shpenzimet tjera operative
40	Tatueshmëria
40	Vlera e tregut dhe menaxhimi i riskut
41	Zotimet dhe detyrimet kontingjente
42	Shpalosjet me palët e ndrlidhura dhe përqëndrimet e ekspozimit
44	Pozicioni i monedhave
45	Analiza e maturiteteve të aseteve dhe detyrimeve



Raporti i Auditorëve të Pavarur

Aksionarëve të bankës ekonomike, sh. a. Prishtinë,

Ne kemi audituar bilancin e Bankës Ekonomike sh. a. Prishtinë ("Banka") me 31 Dhjetor 2004 dhe 31 Dhjetor 2003, si dhe pasqyrat e operimeve, ndryshimet në kapitalin e aksionarëve dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitet që kanë përfunduar. Këto pasqyra financiare janë përgjegjësi e drejtuesëve të Bankës. Përgjegjësia jonë është të japim opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimet tona.

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të nxjerra nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të dhënë një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare mos të përmbajnë gabime materiale. Auditimi përfshin ekzaminimin, në bazë të testeve, të të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Auditimi, gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimet e bëra nga Banka, si dhe vlerësimin mbi paraqitjen e përgjithëshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë që auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për dhënien e opinionit.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës me 31 Dhjetor 2004 dhe 2003 dhe rezultatet operative të saj; ndryshimet në kapitalin e aksionarëve, dhe rrjedhjen e parasë për vitet që përfundojnë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte & Touche,
Prishtinë

14 Shkurt, 2005

1. BILANCI

	Shënimi	31 Dhjetor, 2004	31 Dhjetor, 2003
		(në EUR 000)	(në EUR 000)
Asetet			
Paraja në dorë dhe në banka	3	14,931	8,336
Bilancet me Autoritetin Bankar të Pagesave të Kosovës	4	4,935	4,943
Kreditë ndaj klientëve	5	16,601	12,288
Llogaritë e arkëtueshme		101	52
Prona, planti and paisjet	6	648	643
Asetet e patrupëzuara	7	72	73
Totali i aseteteve		37,288	26,335
Detyrimet			
Detyrimet ndaj klientëve	8	31,279	21,561
Llogaritë e pagueshme	9	388	354
Totali i detyrimeve		31,667	21,915
Ekuiteti i aksionarëve			
Kapitali aksionar	10	4,725	3,912
Rezervat e lira (vullnetare)	11	102	-
Fitimet e mbajtura		794	508
Totali i ekuitetit të aksionarëve		5,621	4,420
Totali i detyrimeve dhe ekuitetit të aksionarëve		37,288	26,335

Autorizuar për t'u lëshuar nga menaxhmenti me -----

z. Hajrullah Zaiti
Drejtor Ekzekutiv

Znj. Syzana Kaçaniku
Drejtoreshë Financiare

Shënimet në faqet 30 deri në 45 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

2. PASQYRAT E OPERIMEVE

<i>Shënimi</i>	<i>Fund viti 31 Dhjetor, 2004 (në EUR 000)</i>	<i>Fund viti 31 Dhjetor, 2003 (në EUR 000)</i>
Të ardhurat nga interesi:		
Prej individëve dhe ndërmarrjeve	2,155	1,347
Prej institucioneve vendore dhe te jashtme	130	146
